



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

ARJ.nr.188/2023

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ragip Namani, kryetar, Nebojša Boričić dhe Beshir Islami, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit SHPK, “C.”, me seli në P., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Idriz Daci, avokat në Gj., kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), me seli në P., me bazë juridike anulim i vendimit të organit të paditur, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.1086/22 të datës 04.05.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18 Janar 2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e paditësit SHPK., “C.”, me seli në P., ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.1086/22 të datës 04.05.2023.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.1086/22 të datës 04.05.2023, është vendosur si në vijim: REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e paditësit, Sh.p.k., “C.”, me seli në P., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.2614/19, të datës 24.05.2021, VËRTETOHET.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.1086/22 të datës 04.05.2023, paditësi, Shpk “C.”, në afat ligjor në këtë gjykatë parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Propozon që të: I. PRANOHET si e bazuar ankesa e “C.” sh.p.k - RTV 21 për rishqyrtimin e jashtëzakonshme të vendimit gjyqësor, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës K.DH.SH.II.nr.1086/22 të datës 04.05.2023; II. PRISHEN, aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës K.DH.SH.II.nr.1086/22 të datës 04.05.2023 dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal Nr.2614/19 e datës 24.05.2021 dhe III. OBLIGOHET Administrata Tatimore e Kosovës që në afat të përcaktuar me ligj të rimbursoj, përkatësisht të ia kthej Paditësit “C.” sh.p.k., shumë prej 372,353.06 Euro, të cilën kjo kompani është detyruar të paguaj Administratës Tatimore e Kosovës në emër të TVSH-së, duke përfshirë ndëshkimet dhe interesat përkatëse.

Gjykata Supreme, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar, dhe atij të shkallës së parë, sipas kërkesës së paditësit dhe shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës - Departamenti i Ankesave, me nr.199/2013 të datës 02.09.2013, në pikën I. të dispozitivit të vendimit është refuzuar si e pa bazë ankesa nr.199/2013 e datës 04.07.2013, e subjektit Shpk "C." me NRB 70124965 dhe NF 600085361, me pronare A. K., me seli të biznesit në rrugën, P. i M.,- P., në lidhje me nenin 136/a të Ligjit nr. 02/L-28 për Procedurat Administrative dhe Njoftim Rivlerësimet e Tatimit Shtesë të caktuara, konfirmohen si të bazuara. Në pikën II të dispozitivit të vendimit, theksohet se procedura e ankesës nuk ndërpre në sanksionet për mos përmbushje dhe interesin për ndonjë lloj tatimi sipas Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Kundër vendimit të lartë cekur të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), paditësi me padi fillon konflikt administrativ.

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin, A.nr.2614/2019 të datës 24.05.2021, në dispozitiv të tij ka vendosur si në vijim: në pikën I. REFUZOHET kërkesëpadija e paditësit SHPK "C." me seli në P., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Idriz Daci Avokat në G., kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në P., si e pa bazuar. Në pikën II. MBETËT NË FUQI Aktvendimi nr.199/2013 i datës 02.09.2013, i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), me seli në Prishtinë. Në pikën III. PEZULLOHET procedura gjyqësore në pjesën e padisë në këtë konflikt administrativ ku është kërkuar anulimi i vendimit nr.199/2013 i datës 02.09.2013 të Administratës Tatimore të Kosovës me seli në P., lidhur me periudhat tatimore të tatimit në Korporata në lidhje me shpenzimet e borxheve të këqija 2005-2008, sipas padisë së paditësit SHPK "C.", me seli në P., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Idriz Daci, avokat në Gj., sepse paditësi ka heq dorë nga kjo pjesë e padisë. Dhe në pikën IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale në konflikt administrativ.

Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj arsyeton ndër të tjera se: Në procedurën e konfliktit administrativ në rivendosje kjo gjykatë duke vepruar sipas vërejtjeve të dhëna në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit AA.nr.383/2019, ka bërë edhe njëherë vlerësimin e gjitha provave që janë paraqit në procedurën e konfliktit administrativ, janë vlerësuar dispozitat ligjore në fuqi, dhe kjo Gjykata ka vërtetuar të njëjtën gjendjen faktike sikurse e paditura. Gjykata në rivendosje nuk ka mundur të marr parasysh mendimin profesional të ekspertizës financiare që në rastin konkret sipas kësaj gjykate e njëjta nuk është marrë me konstatim të gjendjes faktike në raport me të gjeturat e kontrollit për llojin e tatimit TVSH-ë për periudhën kontestuese të kontrollit por me vlerësime juridike dhe interpretim të normave të aplikueshme tatimore duke rekomanduar të merret për bazë Direktiva e KE 2006/112/EC datës 28.11.2016 për TVSH, me të cilën bazë ligjore paditësi do të lirohej nga pagesa e tatimit shtesë në emër të TVSH-së për periudhën kontestuese të kontrollit. Se gjykata e instancave më të larta në Aktgjykimet e tyre nuk kanë dhënë një rekomandim të vetin se në këtë rast legjislacioni i BE-së sikurse është Direktiva BE/112/EC për TVSH-në, ka epërsi në zbatim në

raport me legjislacionin e brendshëm tatimor në fuqi sikurse janë Rregullorja e TVSH-së nr. 2001/11, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.2002/17, e ndryshuar kjo me Ligjin për TVSH nr.03/L-114, dhe atë me nenin 9.2 të tyre, në raport me llojin e tatimit në periudhën kontestuese.

Tutje theksohet se: e paditura me vendimin kontestues ka konfirmuar parregullsitë e paditësit në mbajtjen e evidencave-regjistrimeve, i cili gjatë lëshimit të faturave të shitjes nuk ka llogaritur TVSH-në për reklama, sponzorime, në shërbimet e telekomunikimit. E paditura konstaton se Direktiva e Këshillit të BE-së 2006/112/EC mbi sistemin e përbashkët të vlerës së shtuar, duhet të zbatohet në rast kur një çështje nuk mund të rregullohet me ligjet që janë të zbatueshme në Kosovë, e që për këtë periudhë të kontrollit 2004-2009 baza ligjore është definuar me Rregulloren e TVSH nr.2002/17 neni 9.2 dhe Ligji për TVSH nr.03/L-114 neni 9.2. Gjykata në procedurën e konfliktit administrativ në rivendosje ka shqyrtuar bazën ligjore të këtyre dispozitave referuese që ka aplikuar e paditura në periudhën e vlerësimit të kontrollit. Nga interpretimi i dispozitës nga neni 9 par.2 i Rregullores për TVSH-ë nr. 2001/11, e ndryshuar me Rregulloren 2002/17, dhe e ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-114, e në të cilat dispozita e paditura e mbështet vendimin e saj kontestues, gjykata ka mund të konstatoj se kjo dispozitë përcakton qartë se, vendi i furnizimit për ofrimin e shërbimeve profesionale nga distanca në lëmin e rrjeteve telekomunikuese, me teknologji të avancuar, është vendi ku selinë e ka subjekti e që në këtë rast është Prishtina-Kosova, ndërsa shërbimet mund të kryhen edhe për klient në Evropë dhe apo gjetiu, andaj edhe me të drejtë këto furnizime të këtu paditësit nga e paditura janë trajtuar si furnizime të tatueshme me normë përkatëse mbi TVSh-në bazuar në nenin 9 paragraf 2, të Rregullores nr.2001/11. Ndryshuar me rregulloren 2002/17 ndryshuar me Ligjin nr.03/L-114 për TVSH-në, akte këto në fuqi në kohën e periudhave të kontrollit sipas raportit të kontrollit të datës 04.06.2013.

Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë, është jo kontestues fakti se tani Ligji për TVSH 03/L-145 (në fuqi nga data 29.12.2009), nuk mund të aplikohet në rastin konkret ngase i njëjti nuk ka qenë në fuqi në kohën e kontrollit që u referohet periudhave tatimore 2004-2009 sipas raportit të kontrollit, të datës 04.06.2013, ashtu si nuk është kontestues as fakti se ky ligj e bazuar në Direktivën e BE-së për TVSh-në ka paraparë që tani relacionet e kryerjes se shërbimeve nga personi i tatueshëm për personin e tatueshëm, pranuesi i shërbimit është vendi i furnizimit të shërbimit – sipas rregullave të përgjithshme.

Gjykata e shkallës së parë ka gjetur se një vlerësim dhe interpretim i tillë i dispozitave ligjore ku referohen të dyja palët ndërgjyqëse, është dhënë në një rast të ngjashëm sikurse rasti konkret (provë: Aktgjykimi A.nr.1350/13 dt.26.06.2015), kjo Gjykatë tani është e obliguar ti respektoj dhe harmonizoj qëndrimet e saja me praktikat gjyqësore lidhur me rastet e ngjashme (provë: Aktgjykimi A.A.nr.232/2015 dt.09.03.2016 nga Gjykata e Apelit të Kosovës), ku Kolegji i Apelit, konsideron se Rregullorja 2002/17, Ligji 03/L-1 14 për TVSH, janë ligje të qarta dhe nuk ka paqartësi sa i përket vendit të furnizimeve të shërbimeve jashtë Kosovës (dispozita e nenit 40 të Ligjit 03/L-071 lidhur me nenin 61.3 të Ligjit nr.2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, parimet e Direktivës BE-së, nuk përmenden fare). Prandaj duke marr parasysh se në

rastin konkret kemi të bëjmë kryesisht me interpretim të dispozitave ligjore të aplikueshme në periudhën e vlerësimit të kontrollit 2004-2009 në kuptim të asaj se cilat dispozita kanë përparësi të aplikohen me rastin e ofrimit të shërbimeve jashtë Kosovës, bazuar në legjislacionin e aplikueshëm tatimor kjo gjykatë tani i lë në fuqi vlerësimet faktike dhe juridike të të paditurës.

Gjykata e shkallës së parë vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në përputhje me nenin 31 paragraf 1 të LKA-së, për pezullimin e procedurës gjyqësore, lidhur me anulimin e vendimit nr.199/2013 të datës 02.09.2013 të Administratës Tatimore të Kosovës me seli në P., për periudhat tatimore të tatimit në Korporata në lidhje me shpenzimet e borxheve të këqija 2005-2008, për arsye se paditësi ka hequr dorë nga kjo pjesë e padisë.

Prandaj, gjykata e shkallës së parë, vlerëson se në këtë çështje administrative, në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar gjendja faktike nga e paditura, dhe në mënyrë të drejtë janë zbatuar dispozitat nga e drejta materiale, andaj pretendimet e paditësit i refuzoj si të pabazuara dhe në bazë të nenit 81.1 paragraf 2 pika 2.1 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/-222, nenit 31 paragraf 1, nenit 43 paragraf 1 dhe 46 paragraf 1 dhe 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata Komerciale - dhoma e shkallës së dytë, me aktgjykimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur sipas ankesës së palës paditëse në kuptim të nenit 49 dhe 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA)-së dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) – së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj si më lartë. Në arsyetim pasi bën përshkrimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, bazuar në shkaqet dhe arsyet po ashtu të njëjta, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor, duke vlerësuar se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale me refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit.

Në arsyetim të aktgjykimit të dhomës së shkallës së dytë, të Gjykatës Komerciale, ndër të tjera theksohet se: Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative, dhe nenit 81G të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, ekspertizës financiare dhe provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë iu ka referuar Rregullores së TVSH-së nr. 2001/11 e ndryshuar dhe e plotësuar me rregulloren nr. 2002/17 e ndryshuar kjo me Ligjin për TVSH – në, nr.03/L-114, dhe atë me nenin 9.2 të tyre, në raport me llojin e tatimit në periudhat kontestuese, pasi që paditësi nuk ka arritur të dëshmojë të drejtën e përjashtimit nga TVSH-ja për reklama, shërbime për subjektet e jashtme në kanal in satelitor me mbështetje në legjislacionin e aplikueshëm tatimor të periudhës së kontrollit andaj gjykata vlerëson se me këtë nuk është vërtetuar baza juridike e kërkesëpadisë në këtë pjesë, e me këtë edhe e vet ekspertizës financiare.

Lidhur me pretendimet e paditësit për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhoma e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale në aktgjykimin e saj vlerëson se: Gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka vlerësuar si të pa bazuar pretendimin e paditësit lidhur me kërkesën e tij që trajtimi i TVSH-së që ka të bëjë me shpalljet e reklamave në sinjalet satelitore në territorin jashtë Kosovës, duhet trajtuar nën vështrim të nenit 40 të Ligjit 03/L-071 dhe nenit 61.3 të Ligjit nr. 2004/48 ku dispozita e nenit 40 e Ligjit 03/L-071 dhe neni 61.3 të Ligjit nr.2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat ka të bëjë me masa të përkohshme ndërkombëtare aty ku ligjet ekzistuese tatimore lidhen me taturjen e transaksioneve për TVSH për mallrat dhe shërbimet nuk adresojnë taturjen e tillë, ato mund të plotësohen me parimet e Direktivës së Këshillit të BE-së 2006/112/EC të datës 28 nëntor 2006 mbi sistemin e përbashkët të tatimit në vlerën e shtuar. Gjykata nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore ka konstatuar se kjo dispozitë ligjore nuk mund të aplikohet në rastin konkret, pasi që ekzistojnë ligjet e aplikueshme dhe të qarta që e rregullojnë vendin e furnizimit të shërbimeve. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë në rivendosje nuk ka mundur të marrë parasysh mendimin profesional të ekspertizës financiare që në rastin konkret sipas kësaj gjykate e njëjta nuk është marrë në konstatim të gjendjes faktike në raport me të gjeturat e kontrollit për llojin e tatimit TVSH-në për periudhën kontestuese të kontrollit por me vlerësime juridike dhe interpretime të normave të aplikueshme tatimore duke rekomanduar të merret për bazë Direktiva e BE 2006/112/EC e datës 28.11.2016 për TVSH, me të cilën bazë ligjore paditësi do të lirohej nga pagesa e tatimit shtesë në emër të TVSH-së për periudhën kontestuese të kontrollit. Prandaj, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Gjykata Komerciale - dhoma e shkallës së dytë, duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, konstatoi se vendimi i saj është vendim i drejtë dhe i ligjshëm dhe në kuptim të dispozitave nga neni 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata Supreme duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes si më lartë, vlerësimit të pretendimeve si në kërkesë, ekzaminimit të aktgjykimit të kontestuar dhe të shkallës së parë si dhe shkresave tjera të lëndës vlerëson se, dhoma e shkallës së dytë ka vendosur drejtë dhe në baza ligjore me refuzimin e ankesës të paditësit, dhe vërtetimin e aktgjykimit të shkallës së parë. Qëndrimin juridik të Gjykatës Komerciale por edhe të Gjykatës Themelore, në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë meqë aktgjykimet e kontestuar nuk janë të përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës apo të drejtës materiale, ashtu si pretendon pala paditëse në kërkesën e tij. Aktgjykimet e kontestuar përmbajnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje, nga çka rezulton se drejtë është vërtetuar gjendja faktike me refuzimin si të pabazuar të kërkesë padisë së paditësit.

Bazuar në provat e administruara për mes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve, nga gjykatat e instancës më të ulët, ka rezultuar se vendimi i të paditurës me nr.prot.199/2013 i datës 02.09.2013,

me të cilin refuzohet si e pabazë ankesa me nr.199/2013 e datës 04.07.2013, e subjektit sh.p.k., “C.”, me seli të biznesit në rrugën P. i M., A. – P., në mbështetje të nenit 136/a të Ligjit nr.02/L-28 “Për Procedurat Administrative” dhe Njoftim Rivlerësimet e Tatimit Shtesë të caktuara me kontroll konfirmohen si të bazuara, është vendim i drejtë dhe i ligjshëm.

Rregullorja nr.2001/11, për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, në nenin 9 paragraf 2, lidhur me vendin e furnizimit, thekson se: *“Përveç nëse ndryshe është përcaktuar me rregulloren e tanishme, furnizimi i shërbimeve, duke përfshirë edhe shërbimin e transportimit, bëhet në vendin e biznesit të furnizuesit të shërbimit apo, nëse ky nuk mund të përcaktohet, atëherë në vendin ku shërbimet janë përfituar”.*

Rregullorja nr.2001/17, për ndryshimin e rregullores nr.2001/11 për Tatimin mbi vlerën e shtuar në nenin 9 paragraf 2, lidhur me vendin e furnizimit shprehimisht ka përcaktuar se: *“Përveç nëse është përcaktuar ndryshe me këtë Rregullore, furnizimi i shërbimeve, duke përfshirë edhe shërbimin e transportit, bëhet në vendin e punës së furnizuesit, ndërsa kur kjo nuk mund të përcaktohet, atëherë bëhet në vendin ku ofrohen shërbimet”.*

Në kuptim të nenit 9 paragraf 2 të Ligjit Nr.03/L-114 për tatimin mbi vlerën e shtuar, ku është përcaktuar se: *“Përveç nëse ndryshe është përcaktuar me rregulloren e tanishme, furnizimi i shërbimeve, duke përfshirë edhe shërbimin e transportimit, bëhet në vendin e biznesit të furnizuesit të shërbimit apo, nëse ky nuk mund të përcaktohet, atëherë në vendin ku shërbimet janë përfituar”.*

Në kuptim të dispozitave të lartë cekura gjykatat e instancave më të ulëta me të drejtë kanë gjetur se nuk ka asnjë paqartësi juridike në kuptim të aplikimit të dispozitave ligjore që kanë qenë në fuqi në periudhën kontestuese të kontrollit përkatësisht nga viti 2004 deri më 2009, nga të cilat dispozita theksohet se furnizimi i shërbimeve bëhet në vendin e punës së furnizuesit e që në rastin konkret selia e paditësit “C. Shpk, është në P., Kosovë dhe me këtë rrjedh edhe detyrimi për aplikim të TVSH-së, në faturat sipas raportit të kontrollit të datës 04.06.2013.

Pretendimet e paditësit si në kërkesë, ku theksohet se: gjykata e shkallës së parë hynë panevojshëm në vlerësimin e ekspertizës financiare e që në asnjë mënyrë nuk është detyrë apo obligim i saj, pretendimin se gjykatat e instancave më të ulëta e injorojnë dhe nuk marrin për bazë vërejtjet e dhëna në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme ARJ UZVP Nr.27/2018 të datës 14.03.2018, pretendimin se e paditura ATK nuk ka treguar interesim për pjesëmarrjen aktive në shqyrtim gjyqësor, ndërsa gjykata vlerëson ekskluzivisht parashtrësën e dorëzuar nga e paditura të datës 09.08.2016, me të cilën e kundërshton ekspertizën e ekspertit financiar, pretendimin se gjykata komerciale është dashur që ta udhëzoj paditësin që të kërkoj një ekspertizë tjetër apo edhe super ekspertizë, kolegji i kësaj gjykate njëjtë si gjykatat e instancave më të ulëta i vlerëson si të pabazuara dhe të paqëndrueshme.

Nga shkresat e lëndës shihet se: Gjykata e shkallës së parë në lëndën A.nr.1298/13, sipas propozimit të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse nxjerrë provën me ekspertizë financiare të punuar sipas aktvendimit të datës 13.04.2016. E paditura me parashtrësën e datës 09.08.2016 ka kundërshtuar ekspertizën financiare me arsyetimin se eksperti financiar ka bërë vlerësim të pasaktë

për çështjen e trajtimit të vendit të furnizimit të reklamave dhe shërbimeve të kryera nga subjekti “C.” SHPK jashtë Kosovës për TVSH, për shërbimet për vitet 2005-2009.

Në rivendosje gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas vërejtjeve të dhëna në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit AA.nr.383/2019 të datës 22.10.2019, dhe sipas propozimit të palës paditëse e ka kthyer në plotësim ekspertizën financiare, plotësimin e të cilës e ka pranuar me datë 22.03.2021 si dhe ka bërë edhe njëherë vlerësimin e të gjitha provave. Pala paditëse plotësimin e ekspertizës nuk e ka kundërshtuar dhe as nuk ka propozuar ekspertizë të re. Gjykata e shkallës së parë nuk i fali besimin ekspertizës financiare të punuar nga eksperti financiar sepse e njëjta nuk ka mundur të harmonizoj gjendjen faktike të konceptit, “*Vendi i dhënies së shërbimeve*”, ndryshe nga ajo që është përcaktuar me legjislacionin e brendshëm tatimor në fuqi dhe më tepër bënë interpretim të dispozitave ligjore duke rekomanduar zbatimin e Direktivës së Këshillit të BE-së 2006/112EC për TVSH-në.

Sipas nenit 356 të Ligjit Nr. 03/L-006 të Procedurës Kontestimore, i aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, përcaktohet se: “*Gjykata, me propozimin e palëve mundë të bëjë të provuarit me anë të ekspertizës, sa herë që për vërtetimin apo sqarimin e fakteve, apo të rrethanave të caktuara nevojitet dijëni profesionale të cilën nuk e ka gjyqtari i çështjes*”. Sipas nenit 357 paragraf 2 të këtij ligji, përcaktohet se: “*Palës kundërshtare duhet dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me ekspertizën e propozuar*”. Sipas nenit 366 paragraf 1 të këtij ligji ku përcaktohet se: “*Kur shihet se ekspertimi është i mangët ose i paqartë, si dhe kur ka ndryshim mendimesh midis ekspertëve, gjykata, kryesisht ose me kërkesën e ndonjërës nga palët, mund të kërkojë sqarime plotësuese. Në rast të këtyllës ekspertit i caktohet një afat brenda të cilit duhet të dorëzohet konstatimi dhe mendimi me shkrim. Sipas nenit 366 paragraf 2 të tij përcaktohet se: “*Po që se eksperti as pas thirrjes së gjykatës nuk e paraqet konstatimin dhe mendimin e plotë dhe të qartë, gjykata, pas deklarimit të bërë nga palët, cakton ekspertin tjetër për ekspertim*”.*

Sipas nenit 41, paragraf 1 të Ligjit nr. 03/l-202 për Konfliktet Administrative, përcaktohet se: “*Mungesa e palës në shqyrtimin verbal nuk e pezullon punën e gjykatës, dhe paragraf 2, “Për shkak të mungesës së palëve nuk mund të konstatohet se ato kanë hequr dorë nga kërkesat e tyre, por do të lexohen parashtresat e tyre*”. Në kuptim të nenit 43 të këtij ligji, është përcaktuar se: “*Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative*”, dhe nenit 8 të Ligjit Nr.03/l-006 për Procedurën Kontestimore, ku përcaktohet se: “*Se cilat fakte do t’i konsiderojë të provuara e cilat jo, vendosë vetë gjykata në bazë të çmuarjes me ndërgjegje, e të kujdesshme të provave, por edhe në bazë të rezultatit të gjithë procedimit. Gjykata me ndërgjegje dhe me kujdes e çmon ç’do provë veç e veç dhe të gjitha provat së bashku*”. Ndërsa në kuptim të nenit 7 të Ligjit nr. 03/l-006 për Procedurën Kontestimore, përcaktohet se: “*Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla*”.

Bazuar në dispozitat e cituara si më lartë sipas vlerësimit të kësaj gjykate ekspertiza financiare, e punuar nga eksperti M. Prekazi, nuk është marrë me konstatim të gjendjes faktike në raport me të

gjeturat e kontrollit për llojin e tatimit TVSH-në për periudhën kontestuese të kontrollit por me vlerësime juridike dhe interpretime të normave të aplikueshme tatimore, njëherit duke i rekomanduar gjykatës që të merret për bazë Direktiva e BE 2006/112/EC e datës 28.11.2016 për TVSH, me të cilën bazë ligjore paditësi do të lirohej nga pagesa e tatimit shtesë në emër të TVSH-së për periudhën kontestuese të kontrollit, andaj si të tillë gjykatat e instancave më të ulëta për këtë pjesë me të drejtë nuk ja kanë falur besimin. Edhe kolegji i kësaj gjykate vlerëson se në rastin konkret ekzistojnë dispozitat ligjore që shprehimisht e rregullojnë çështjen kontestuese, siç është legjislacioni tatimor i aplikueshëm për periudhat e kontrollit 2004-2009. Ndërsa Direktiva e Këshillit të BE-së 2006/112/EC e datës 28.11.2016 për TVSH, mund të aplikohet në rastet kur ligjet ekzistuese tatimore nuk adresojnë apo plotësojnë fushat e caktuar të tatimit në vlerën e shtuar për mallrat dhe shërbimet mbi sistemin e përbashkët.

Pretendimet se aktgjykimet e kontestuara janë të përfshirë me zbatim të gabuar të drejtës materiale, kolegji i Gjykatës Supreme po ashtu këto pretendime i vlerëson si jo të qëndrueshme dhe të pa argumentuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje nga ajo e vendosur nga instancat më të ulëta.

Gjykata shqyrtoj edhe pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës, por vlerësoj se të njëjtat janë shqyrtuar nga gjykatat e instancave më të ulëta, të njëjtat janë të pabazuara, të paqëndrueshme dhe të pa argumentuara, për një vendosje ndryshe në këtë çështje nga çka kanë vendosur gjykatat e instancave më të ulëta. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate gjykatat e instancave më të ulëta kanë vepruar në baza ligjore me vendosjen e çështjes, duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të shkallës së parë, i vërtetuar në procedurë ankimore nga gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata nuk shqyrtoi pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës, lidhur me konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke pasur parasysh se, sipas dispozitës së nenit 24 paragraf 2 të LKA-së, përcaktohet se: “Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit mund të parashtrohet vetëm për shkak të shkeljes të drejtës materiale ose të shkeljeve të dispozitave të procedurës, që do të mund të kishte ndikim në zgjidhjen e çështjes”.

Nga se u theksua si më lartë, e në bazë të nenit 54 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË
ARJ.nr.188/2023, më datë 18 Janar 2024

B. Profesionale,
Zanë Buçinca

Kryetari i Kolegjit,
Ragip Namani